



Prishtinë: 27.11.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1207_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1803_05_18**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **18.11.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 27.11.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F. R. nga Prishtina me shifër të konsumatorit DPR - 102041 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1803_05_18 i datës 15.05.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.11.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori F.R. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se ZRRE gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës, pasi konsumatori në fjalë është ngarkuar me paushall, si ajo e Marsit 2013, pasi që aty muaj nuk qenë askush në shtëpi. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se këtu ka ardhur deri te gabimi teknik. Gjithashtu konsumatori në ankesë ka theksuar se shërbimi i faturimit i KEK te kjo faturë ka rezultuar te KEDS dhe i kërkoj Bordit që këtë faturë të përcjell te departamenti ligjor i KEDS dhe të qojë në përmbarim dhe jo të shkyçin energjinë elektrike.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit ZRRE gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës, pasi konsumatori në fjalë është ngarkuar me paushall, si ajo e Marsit 2013, pasi që aty muaj nuk qenë askush në shtëpi, Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkalës së parë është i bazuar në të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga vet konsumatori dhe nga vet KEDS/KESCO. Se vendimi i shkalës së parë është i saktë dhe i bazuar në prova konkrete e dëshmon edhe fakti se organi i shkalës së parë ka analizuar procesverbalin e inspektimit nr.1746165 të datës 29.02.2016 dhe gjatë analizës ka konstatuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në



njehsorin elektrik nr.4194181 prej TL=32392 kWh dhe TU=20756 kWh e evidentuar në procesverbalin e lartcekur përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në programin e faturimit – CCP (ang. Customer Care Package) për periudhën 02/2016. Bordi i ZRRE thekson se fakt tjetër që e dëshmon se vendimi i organi të shkallës së parë është i saktë dhe i bazuar në prova konkrete është edhe analizimi i listave të leximit dhe rrjedhës së energjisë elektrike aktive, e ku konstatohet se shpenzimet e energjisë elektrike aktive të evidentuara në listat e leximit përputhen me shpenzimet e evidentuara në rrjedhën e energjisë elektrike aktive.

Bordi i ZRRE ka analizuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit dhe gjatë analizës së bërë shpenzimeve të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, përveç periudhës 01/2013 kur është faturuar konsumatori pa matje/paushall dhe pastaj prapë ka vazhduar faturimi me rregull. Bordi i ZRRE bazuar në analizën e bërë rrjedhës së energjisë elektrike për periudhën kontestuese me njehsorin elektrik nr.4194181 krahasuar me shpenzimet e energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, ka konstatuar se ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE ka bërë analizimin e konsumit të energjisë së konsumatorit për periudha të njëjta kohore para, pas dhe gjatë kontestit dhe ka vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit me njehsorin elektrik nr.4194181 për periudhën para kontestit është: prej periudhës 01/2012 deri në periudhën 03/2012 është **1427.33 kWh/muaj**, prej periudhës 01/2011 deri në periudhën 03/2011 është **977.67 kWh/muaj**; mesatarja mujore e shpenzimit me njehsorin elektrik nr.4194181 për periudhën pas kontestit është: prej periudhës 01/2015 deri në periudhën 03/2015 është **845 kWh/muaj**, prej periudhës 01/2016 deri në periudhën 03/2016 është **1145.67 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit me njehsorin elektrik nr.4194181 për periudhën gjatë kontestit është: prej periudhës 01/2013 deri në periudhën 03/2013 është **3,373.00 kWh/muaj**. Pra, Bordi i ZRRE thekson se nga analizat e bërë shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para dhe pas periudhës kontestuese nuk ka ndonjë ndryshim të madh, por që këto dy periudha kanë ndryshim të madh të shpenzimit me periudhën gjatë kontestit, e kjo përshkak të mos leximit të saktë të periudhës 01/2013.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se është bërë gabim teknik, Bordi i ZRRE-së thekson se një gjë të tillë nuk e ka vërejtur sei gabim teknik, por që sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë elektrike të konsumatorit vërehet se në periudhën 01/2013 konsumatori nuk ka lexim dhe faturim me matje, por ka lexim dhe faturim pa matje/paushall, ndërsa në muajin 02/2013 vërehet se kemi lexim dhe faturim me matje dhe se nëse bëhet shpërndarja e shpenzimit për periudhën 01/2013 – 02/2013 rezulton se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e konsumatorit është 3,816.5 kWh/muaj. Megjithatë Bordi i ZRRE thekson se sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit rezulton se konsumatori shpenzim të ngjashëm si këto periudha ka edhe në muajt para periudhës kontestuese, si periudha 02/2009 me shpenzim prej 2,109 kWh, periudha 03/2009 me shpenzim prej 1,946 kWh, periudha 12/2009 me shpenzim prej 2,171 kWh, periudha 02/2010 me shpenzim prej 3,288 kWh, periudha 10/2010 me shpenzim prej 1,805 kWh, andaj edhe nuk mund të konstatohet se ka gabim teknik.

Bazuar në konstatimet e bëra më lartë Bordi i ZRRE thekson se ka bërë edhe shpërndarjen proporcionale të shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 01/2013 deri më 03/2013 dhe pas shpërndarjes së shpenzimit nuk rezulton se konsumatori duhet të korrigohet financiarisht, pasi nuk ka elemente të korrigjimit financiar që duhet t'i bëhen konsumatorit. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se vendimi i organit të shkallës së parë se për shkak të grumbullimit të shpenzimit të energjisë elektrike të muajit 02/2013, KESCO duhet t'i ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese prej 3 muajve është i saktë dhe i drejtë.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se sipas konsumatorit kjo faturë është dashur të jetë e KEK por ka rezultuar te KEDS dhe i kërkoj Bordit që këtë faturë të përcjell te departamenti ligjor



i KEDS dhe të qojë në përmbarrim, Bordi i ZRRE-së thekson se organi i shkallës së parë ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit gjatë periudhave të ndryshme kohore dhe si para ashtu edhe pas periudhës kontestuese. Lidhur me këtë vlen të theksohet se për ZRRE objekt kontesti ka qenë faturat 01/2013 – 03/2013 dhe ajo a janë të KEK apo KEDS pasi që edhe pas privatizimit është bërë bartja e licencës së operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe bartja e licencës së furnizuesit të energjisë elektrike nga pronësia e shtetit në pronësinë private, mirëpo aktivitet kanë vazhduar. Gjithashtu Bordi i ZRRE ju njofton se nuk është kompetencë e ZRRE se a e dërgon KESCO borxhin e konsumatorit te përmbarruesi apo jo, ajo është përgjegjësi e të licencuarit KESCO dhe se për ZRRE ka qenë vetëm se a ka qenë faturat në rregull apo jo.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme dhe duke kërkuar kompensim dëmi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit F. R.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së